



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOŠOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nisja Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/02	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	541/2022
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	5	Data Datum Date:	24/03/2022
Hyriose		PRISHTINE/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 19/2022  
Datë: 24.03.2022

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, plotësuar ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 i datës 25.08.2021, dhe plotësuar ndryshuar me Vendimin Nr. 01/49 i datës 17.12.2021, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**për caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.6- Mbështetja e personave me nevoja të veçanta në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike**

**A. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT**

1. Të drejtë aplikimi për implementimin e kësaj mase kanë të gjitha organizatat jo-qeveritare (këtej e tutje referuar si OJQ) të regjistruara në Ministrinë e Punëve të Brendshme, fushëveprimtaria e të cilave ndërlidhet me mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara (këtej e tutje referuar si të trajnuarit).
2. Implementimi i masës do të realizohet përmes programeve të OJQ-ve përfituese, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në bazë të së cilave zhvillohen trajnime për aftësim profesional për të trajnuarit, në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj.
3. Trajnimet për aftësim profesional për të trajnuarit, mund të zhvillohen në shoqëri tregtare (biznese) apo entitete tjera që ofrojnë shërbime të tilla.
4. OJQ-të do të bëjnë përzgjedhjen e të trajnuarve që do të ndjekin trajnimet për aftësim profesional dhe përshtatjen e të njejtëve me shoqërinë tregtare (biznesin) apo ndonjë entitet tjetër ku do ta ndjekin trajnimin.

5. Të trajnuarit gjatë periudhës që do të ndjekin trajnimet për aftësim profesional, do të kompensohen në vlerë 170 € (njëqind e shtatëdhjetë euro) në muaj.
6. Shoqëria tregtare (biznesi) apo ndonjë entitet tjetër ku ndjeket trajnimi nga të trajnuarit kompensohet në vlerë 100€ (njëqind euro), për person në muaj.

#### **B. MËNYRA E APLIKIMIT PËR OJQ-të**

7. Aplikacioni për të përfituar nga kjo mbështetje bëhet përmes e-mail adresës zyrtare, të cilën Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet që në kohë optimale nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ta publikojë.
8. Dokumentacioni i nevojshëm për këtë aplikim është si në vijim:
  - 8.1.Çertifikata e regjistrimit të entitetit;
  - 8.2.Dëshmi rreth punës së OJQ-së (misioni, vizioni, aktivitetet, numri i anëtarëve etj); dhe
  - 8.3.Programi me aktivitetet e planifikuara për trajnime.
9. Afati për aplikim për OJQ mbetet i hapur deri me datën 15 Prill 2022, ndërsa afati për dorëzimin e listave me të dhënat e të trajnuarve tek Komisioni Zbatues do të jetë i hapur deri me 30 Qershor 2022.

#### **C. PËRZGJEDHJA E OJQ-ve PËRFITUESE**

10. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes një vendimi të veçantë, themelon një Komision për shqyrtimin e aplikimeve për të përfituar nga masa e përcaktuar me këtë vendim.
11. Komisioni sipas pikës 10 të këtij vendimi, ka të drejtë të saktësojë kriteret dhe kushtet për përzgjedhje të OJQ-ve, si dhe të kërkojë dokumente tjera shtesë të cilat ndërlidhen me programin për trajnime për aftësim profesional për të trajnuarit.
12. Aplikacionet nga OJQ-të që nuk përmbushin kushtet dhe kriteret të përcaktuara sipas këtij vendimi, do të refuzohen.
13. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidh marrëveshje të veçantë me OJQ-të, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

#### **D. LIDHJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

14. Pas përfundimit të periudhës trajnuese, të trajnuarit që kanë përfunduar trajnimin dhe shoqëria tregtare (biznesi) apo entiteti ku kanë ndjekur trajnimin mund të lidhin kontratë të rregullt pune.

15. Të trajnuarit që lidhin kontratë të rregullt pune sipas pikës 14 të këtij vendimi, do të subvencionohen në vlerë të shumës financiare prej 270 € (dyqind e shtatëdhjetë euro) në muaj, për gjashtë (6) muaj.
16. OJQ-të duhet të dërgojnë listat e të trajnuarve të cilët kanë lidhur marrëdhënie të rregullt të punës tek Komisioni Zbatues, ku pastaj këto të dhëna Komisioni Zbatues i konfirmon me Administratën Tatimore të Kosovës.

#### **E. NDËRPRERJA E SUBVENCIONIMIT**

17. Subvencionimi për të trajnuarin specifik ndërprehet në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës, e lidhur sipas pikës 14 të këtij vendimi, për çfarëdo arsye dhe largimit nga lista e të punësuarve në deklaratën e shoqërisë tregtare (biznesit) apo entitetit.
18. Subvencionimi ndërprehet në rastin kur shoqëria tregtare (biznesi) apo entiteti nuk i paguan kontributet pensionale, pavarësisht nëse të njëjtat janë deklaruar në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës.

#### **F. ZBATIMI I VENDIMIT**


19. OJQ-të përfituese duhet të dërgojnë në vazhdimësi listat tek Komisioni Zbatues, me të dhënat e të trajnuarve si dhe të dhënat e shoqërive tregtare (bizneseve) apo entiteteve tjera në të cilat ndjekën trajnimet, si dhe dokumentacionin tjetër përkatës. Të dhënat që duhet të përmbajnë këto lista si dhe dokumentacioni tjetër përkatës, përcaktohen në marrëveshjen e veçantë në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe OJQ-së, sipas pikës 13 të këtij vendimi.
20. Pas aprovimit të listave të dërguara nga Komisioni Zbatues sipas pikës 19 të këtij vendimi, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit për trajnime në llogari bankare të përfituesve.
21. Në rastet kur të trajnuarit kanë lidhur marrëdhënie pune pas periudhës trajnuese, sipas pikës 14 të këtij vendimi, atëherë pas aprovimit të listës së përfituesve nga Komisioni Zbatues, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogari bankare të punëdhënësit.
22. Mjetet buxhetore të nevojshme për zbatimin e masës do të ndahen me vendim të veçantë nga Qeveria e Republikës së Kosovës tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më saktësisht programi Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.
23. Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, listën finale me shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës, e procedon tek Thesari për ekzekutim në baza mujore.

24. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

### **G. HYRJA NË FUQI**

25. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

**Hekuran Murati**



---

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi i'u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; dhe
- Arkivit të MFPT-së